Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve:

5(pese) muaj nga nenshkrimi i kontrates.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019,2020,2021 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **13,735,075(trembëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e pesë mijë e shtatëdhjetë e pesë)lekë.**

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ligjit nr.10091 date 5.3.2009 *”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar”* i ndryshuar, ku bilancet e dy viteteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.2.3. Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 *“Për sistemin e taksave vendore”*, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është rregjistruar sipas QKB-se).

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
 - b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës së fondit limit të kontratës që prokurohet.
- Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*
- iv. *Formular Vlerësimi nga Investitori sipas Shtojcës nr.9*

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve si dhe dokumentat e mëposhtëm:

- i. *Kontratën e Sipërmarrjes,*
- ii. *Situacion përfundimtar të objektit,*
- iii. *Aktin e Kolaudimit të objektit,*

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise, në bazë të VKM Nr 42 dt 16.01.2008 i ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- a. NP-1: Punime gërmimi në tokë. “Kategoria A”.
- b. NP-2: Ndërtime civile dhe industriale “Kategoria A”.
- c. NP-3: Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. “Kategoria A”.
- d. NS-1: Punime për prishjen e ndërtimeve “Kategoria A”
- e. NS-2: Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre “Kategoria A”.
- f. NS-4: Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese “Kategoria A”

- g. N.S-14:Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj. “Kategoria A”

Ne rast bashkimi operatorësh secili duhet të disponojë kategoritë e licencës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

➤ **NP-1: Punime gërmimi në tokë.**

“Kategoria A”

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore

➤ **NP-2: Ndërtime civile dhe industriale**

“Kategoria A”.

Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.

Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazërma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

➤ **N.P. 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash**

“Kategoria A”

Konsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim, konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje..

➤ **N.S. 1: Punime për prishjen e ndërtimeve**

“Kategoria A”

Konsiderohet çmontimi i impianteve industriale dhe prishja komplet e ndërtesave me pajisje speciale ose me përdorim eksploziv me prerje të strukturave betonarme dhe prishjeve në përgjithësi përfshi edhe grumbullimin e mbeturinave, ndarjen e tyre dhe riciklimin e materialeve.

➤ **N.S-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre “Kategoria A”**

Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

➤ **NS-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese “Kategoria A”**

Konsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.

Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtme të dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me

metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.

➤ **N.S- 14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV**

Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme. **“Kategoria A”**

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse																
NP-1	Punime gjurmimi në tokë		Kategoria A	0-20 milion lekë																
NP-2	Ndërtime civile dhe industriale	<table border="1"> <tr><td>Arkitra b/a C 16/20</td></tr> <tr><td>F.V. hekur betoni $\varnothing < 10$</td></tr> <tr><td>F.V. hekur betoni $\varnothing > 12$</td></tr> <tr><td>Mur me blloqe betoni t=20 cm</td></tr> <tr><td>Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah</td></tr> <tr><td>Suvatim mure te brendeshme me drejtues</td></tr> <tr><td>Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m</td></tr> <tr><td>F.V. gone per kullim e ujit te shiut</td></tr> <tr><td>Termoizolim tarace</td></tr> <tr><td>Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm</td></tr> <tr><td>Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a.</td></tr> <tr><td>Dritare d/alumini tek xham.</td></tr> <tr><td>F.V bazamake dritareje t=3cm</td></tr> <tr><td>Llac cemento per nivelim t= 2 cm</td></tr> <tr><td>H/izolim me 2 duar guajne importi.</td></tr> <tr><td>Prishje mur me blloqe</td></tr> </table>	Arkitra b/a C 16/20	F.V. hekur betoni $\varnothing < 10$	F.V. hekur betoni $\varnothing > 12$	Mur me blloqe betoni t=20 cm	Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah	Suvatim mure te brendeshme me drejtues	Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m	F.V. gone per kullim e ujit te shiut	Termoizolim tarace	Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm	Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a.	Dritare d/alumini tek xham.	F.V bazamake dritareje t=3cm	Llac cemento per nivelim t= 2 cm	H/izolim me 2 duar guajne importi.	Prishje mur me blloqe	Kategoria A	0-20 milion lekë
Arkitra b/a C 16/20																				
F.V. hekur betoni $\varnothing < 10$																				
F.V. hekur betoni $\varnothing > 12$																				
Mur me blloqe betoni t=20 cm																				
Suva solete h ~ 4 m me drejtues, me krah																				
Suvatim mure te brendeshme me drejtues																				
Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m																				
F.V. gone per kullim e ujit te shiut																				
Termoizolim tarace																				
Shtrese lluster cemento 1:2, t = 20 mm																				
Dere d/alumini pa xham,me mbushje d/a.																				
Dritare d/alumini tek xham.																				
F.V bazamake dritareje t=3cm																				
Llac cemento per nivelim t= 2 cm																				
H/izolim me 2 duar guajne importi.																				
Prishje mur me blloqe																				

		Lyerje me boje hidro-plastike		
		Boje hidroplastike importi cilesi e I-re		
		Transport mbeturina inerte		
NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Heqje ulluqe vertikal ekzistuese	Kategoria A	0-20 milion lekë
		Prishje mur tulle nen pragun e dritares		
		Veshje muri brenda me polisterol te thjeshte t=5cm + rrjete + suva+grafiato.		
		Pragje dritareje me mermer t=3 cm		
		Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm		
		Ulluk vertikal shkarkimi alumin t=0.6mm Ø 80mm		
		Veshje kornize llamarine bakri t = 0.8 mm		
		Veshje fasade me polisterol xsp t=2cm + rrjete + suva + grafiato.		
		Heqje pragje dritareje ekzistuese		
		Heqje dritare duralumini ekzistuese		
		Nivelim me beton C 16/20 ne pragjet e dritareve		
		F.v. Dritare duralumini dopio xham		
		F V vetrate d/alumini me dopio xham		
		Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m		
		Boje hidroplastike importi cilesi e I-re		
		Transport mbeturina inerte		
N.S. 1	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje mur me blloqe	Kategoria A	0-20 milion lekë
		Heqje ulluqe vertikal ekzistuese		
		Prishje mur tulle nen pragun e dritares		
		Heqje pragje dritareje ekzistuese		
		Heqje dritare duralumini ekzistuese		
		Prishje h/izolim tarace		
		Prishje veshje me pllka ne tualete		
		Prishje shtrese me pllaka ne tualete.		

		Heqje pajisje + prishje instalime hidrosanitare		
		Heqje dyer te brendeshme ne tualete		
		Riparim suvatim I brendshem		
N.S. 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	Riparim suvatim I brendshem	Kategoria A	0-20 milion lekë
		Hidroizolim dysHEMEJE me nje shtrese mapej		
		Hidroizolim mure me nje shtrese mapej		
		Shtrese me pllaka		
		Veshje me pllaka		
		V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara		
		F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, PN 16		
		F.V Tuba e rakorderi PVC		
		F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 mm		
		F.V lavaman porcelani importi me mishelator		
		F.V WC allafrenga importi		
		F.V bide importi porcelani		
		F V bolier 80 liter, uje te ngrohte		
		Transport mbeturinash		
N.S. 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese	Riparim suvatim I brendshem	Kategoria A	0-20 milion lekë
		Shtrese me pllaka		
		Veshje me pllaka		
		Lyerje me boje hidroplastike kati perdhe		
		Lyerje me boje hidroplastike kati pare		
		Boje hidroplastike importi cilesi e I-re parruket e ballkonit		
		Stukime te ndryshme ne murature		
		Veshje muri brenda me polisterol te thjeshte t=5cm + rrjete + suva+grafiato.		
		Pragje dritareje me mermer t=3 cm		
		Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm		

		Ulluk vertikal shkarkimi alumin t=0.6mm Ø 80mm		
		Veshje kornize llamarine bakri t = 0.8 mm		
		Veshje fasade me polisterol xsp t=2cm + rrjete + suva + grafiato.		
		Nivelim me beton C 16/20 ne pragjet e dritareve		
		F.v. Dritare duralumini dopio xham		
		F V vetrate d/alumini me dopio xham		
		Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m		
		Boje hidroplastike importi cilesi e I-re		
N.S. 4	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtese	Riparim suvatim I brendshem	Kategoria A	0-20 milion lekë
		Shtrese me pllaka		
		Veshje me pllaka		
		Lyerje me boje hidroplastike kati perdhe		
		Lyerje me boje hidroplastike kati pare		
		Boje hidroplastike importi cilesi e I-re parmaket e ballkonit		
		Stukime te ndryshme ne murature		
		Veshje muri brenda me polisterol te thjeshte t=5cm + rrjete + suva+grafiato.		
		Pragje dritareje me mermer t=3 cm		
		Kasete shkarkimi me llamarine bakri 1.0mm		
		Ulluk vertikal shkarkimi alumin t=0.6mm Ø 80mm		
		Veshje kornize llamarine bakri t = 0.8 mm		
		Veshje fasade me polisterol xsp t=2cm + rrjete + suva + grafiato.		
		Nivelim me beton C 16/20 ne pragjet e dritareve		
		F.v. Dritare duralumini dopio xham		
		F V vetrate d/alumini me dopio xham		
		Suva e zakonshme fasade mur tulle lartesi mbi 8 m		
		Boje hidroplastike importi cilesi e I-re		

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. Inxhinier ndertimi 1 (nje)
- b. Inxhinier mekanik 1 (nje)
- c. Inxhinier elektrike 1 (nje)
- d. Inxhinier hidroteknik 1 (nje)
- e. Inxhinier topograf 1 (nje)
- f. Arkitekt 1 (nje)

Per kete duhet te paraqes Diplome, CV, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.4. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. **1 (nje) punonjes** , qe përmbush kriteret për të qenë “Koordinator ne fushën e sigurisë dhe te shëndetit” gjate realizimit te punimeve, sipas kërkesave te ligjit nr.10237 dt18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin ne pune” dhe VKM nr. 312 date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë ne kantier”;
- b. **1(nje)Punonjës** te pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c. **1 (nje) punonjes** i pajisur me Certifikate: Ekspert ne fushën e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin.
- d. **1 (nje) punonjes** i cili të disponojnë certifikatë të trajnimit si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier.

Per kete duhet te paraqes certifikate, kontrate pune te vlefshme, dhe te figuroj ne listpagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim. Ne fazen e ofertimit Operatori ekonomik ploteson formularin permbledhes te vetedeklarimit.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetedeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- a. **Teknike ndertimi 1 (nje)** per kete duhet te paraqes Diplome te shkolles se mesme, kontrate pune te vlefshme ,IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.

- b. **Specialiste karpentiere4 (kater)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.
- c. **Specialiste pllakashtrues 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.
- d. **Specialiste suvatues 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.
- e. **Elektriciste 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.
- f. **Specialist per kondicionere dhe sistme ngrohese/ftohese 1 (nje)**) per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.
- g. **Hidraulike 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.
- h. **Bojaxhinje 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.
- i. **Shofere 2 (dy)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.
- j. **Manovratore 3(tre)** per kete duhet te paraqes, kontrate pune te vlefshme leje drejtimi, IQT (ekuivalente) dhe te figuroj ne listepagesen e shoqerise nga muaji Korrik 2022 e ne vazhdim.

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- diplome,
- kontrata pune,
- deshmi kualifikimi
- Ne raste kur makinerite disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.

.....
(Shënim: listoni dokumentacionin provues që dëshmon disponimin e stafit kryesor, mbështetës dhe të specializuar/kualifikuar të kërkuar, dhe nëse është rasti kërkesat për licencat profesionale individuale, apo certifikimet/kualifikimet që duhet të disponojnë anëtarët e stafit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe insitucionin që lëshon këto licenca apo certifikime/kualifikime).

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndertimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për ndërtimin e objektit, zbërthimin e projektit konstruktiv, punimet e betonit të hekurit, punimet e muraturës, shtresave të rruges etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të betonit, hekurit etj.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve mekanike ne objektin qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve qe lidhen me punimet mekanike (sistemi i kondicionimit) qe do te instalohen ne objektit, zbërthimin e projektit te kondicionimit, punimet per shtrimin e linjave dhe montimin e pajisjeve te sistemit te kondicionimit etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh të tubove dhe rakorderive te bakrit, pajisjeve dhe mberthimit te tyre etj
- **Inxhinieri Elektrik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve elektrike te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve elektrike, telefonike dhe te rrejtji CCTV të objektit, zbërthimin e projektit te instalimeve elektrike, telefonike, internetit etj, punimet per montimin e

pajisjeve dhe lidhjen e tyre etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve si psh linjat elektrike, linja te internetit, linjae e sistemit CCTV dhe te pajisjeve t eketyre rjeteve etj

- **Inxhinieri Hidroteknik** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike te objektit qe prokurohet, zbërthimin e projektit , për sistemin hidrik te rrjedhes se ujit ne tubacionet e furnizimit me uje dhe ne tuabcionet e ujrave te bardha dhe te zeza qe do te vendosen ne objekt si dhe lidhjen e tyre me rrjetin ekzistues apo te ardhshem.
- **Inxhinieri Gjeodet** është përgjegjës për zbatimin e saktë të piketimit te objektit qe prokurohet, zbërthimin e permasave te projektit konstruktiv dhe arkitektonik, punimet topografike te kuotave te objektit ekzistues dhe atij qe do te ndertohet.etj. Ai është përgjegjës për nivelin (kuoten) dhe permasat e elementeve te objektit etj
- **Arkitekti** është përgjegjës për zbatimin e saktë ne pergjithasi të punimeve te objektit qe prokurohet për secilin nga zërat e punimeve te rifinitures, permasave etj për ndërtimin e objektit, zbërthimin e projektit arkitektonik dhe elementet e tij, punimet e rifiniturave, bashkimit te elementeve etj. Ai është përgjegjës për cilësinë e materialeve qe do te perdoren dhe per pamjen vizuale te tyre etj
- **Specialisti** (profili - karpentier, nivelues betoni, shtrues pllakash, Suvatues etj) eshte pergjegjes (sipas profileve)
 - Per pergatitjen e armatures se derrases dhe betonimin e strukturave te ndryshme b/a, ne objektik qe prokurohet.
 - Per niveimin e strukturave beton, b/a , llace nivelimi etj ne objektin qe prokurohet.
 - Per shtrimin e pllakave te brendeshme dhe te jashtme ne objektin qe prokurohet.
 - Per suvatimin e siperfaqeve te mureve dhe soletes , te brendshme dhe te jashtme ne objektin qe prokurohet.
- **Elektracisti** eshte pergjegjes per pergatitjen dhe betonimin e shtresave dhe veshjave anesore me beton ose b/a ne objektik qe prokurohet.
- **Hidrauliku** eshte pergjegjes per pergatitjen dhe betonimin e shtresave dhe veshjave anesore me beton ose b/a ne objektik qe prokurohet.
- **Bojaxhiu** eshte pergjegjes per zbatimin e punimeve te veshjes me system kapot te godines dhe lyerjen me boje grafiato ne pjesen e jashtme dhe me boje hidropalstike ne pjesen e brendshem ne objektin qe prokurohet.
- **Shofere** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantiar dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes do te jene te kontraktuar.
- **Manovratore** jane personat pergjegjes per drejtimin e makinerive ne kantiar dhe jashte kantierit per furnizimin dhe transportin e materialeve te nevojshme per objektin qe prokurohet. Ne raste kur makinerit disponohen me qera, keta punonjes mund te jene te kontraktuar.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 27 (njëzetë e shtatë) persona.**

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Dokumentat për të vërtetuar këtë kriter janë:

- a) *Vertetim te leshuar nga Dega e Tatimeve te Rrethit ose nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore te rrethit perkates ose me vule elektronike .*

b) Listepagesat per periudhen e mesiperme (E-sig 25)

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Referuar kategorise se punimeve si dhe afatit, stafi i kerkuar duhet te jete:

- **Teknike ndertimi** 1(nje)
- **Karpentier** 4 (kater).
- **Pllakashtrues** 2 (dy)
- **Elektriciste** 2 (dy).
- **Specialist per kondicionere dhe sistme ngrohese/ftohese** 1 (nje)
- **Hidraulike** 2 (dy).
- **Bojaxhinj** 2 (dy).
- **Suvatues** 2(dy)
- **Shofere** 2 (dy).
- **Maovratore** 3 (tre)
- **Drejtues Teknik** 6 (gjashte)

TOTALI = 27 Persona ne Staf.

Shenim: Argumetnimi i nr. te punonjeseve behet vetem me qellim per justifikimin e stafit te kerkuar. Ndarja sipas specialiteteve ne kete rubrike te mos merret ne konsiderate ne plotesimin e kriterëve te percaktuara.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

- **Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtes (8-10 ton)** cope 2 (dy)
- **Kamiocine deri ne 3.5 ton** cope 1 (nje)
- **Mini Fadrome** cope 1 (nje)
- **Skrep** cope 1 (nje)
- **Betoniere** cope 2 (dy)
- **Depozite uji mbi 5000 Litra** cope 1 (nje)
- **Matrapik** cope2 (dy)
- **Gjenerator 3.5KVA** cope 2 (dy)
- **Skela metalike** m2 150

Ofertuesi për makineritë, të cilat janë në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë, dokumentacionin e mëposhtem:

- lejen e qarkullimit.
- certifikatat e pronësisë,
- siguracionin e mjetit.
- kolaudimin,
- certifikatë transporti
- fotografi të mjetit te paraqitura. (të cilat duhet të jenë në emër të shoqërisë ose në emër të qeradhënësit) .

Për mjetet dhe pajisjet te cilat nuk kanë leje qarkullimi, Ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratë noteriale të blerjes,
- fatura tatimore të blerjes ose dokumenta zhdoganimit të mjetit.

Pranohet marrja me qera e mjeteve të mësipërme, me kusht që kontrata e qeramarrjes të jetë bërë para noterit, me afat vlefshmërie brenda afatit të zbatimit të punimeve për këtë objekt.

- a) *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit, , leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik , siguracionin e mjetit (të vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që vërteton regjistrimin e tij, leje qarkullimi, plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit,(të vlefshme) , të shoqëruar me kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit noteriale,, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.*
- b) *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- c) **Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës perkatese (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).**

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

2.3.8 Mbështetur në:

Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta, Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 PER DISA NDRYSHIME NE LEGJISLACIONIN NE FUQI PER LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE

Kreu II Neni 9 Detyrime te krijuesit te mbetjeve

Neni 12 Perpunimi dhe asgjesimi i mbetjeve te ndertimit

Neni 24/1

Neni 25 Lejet mjedisore

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licensën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Certifikat ISO:

Certifikat ISO:

- a) **ISO 9001-2015 – Standard per Sistemin e Menaxhimit te Cilesise ose ekuivalente (e vlefshme).** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

- b) ISO 14001 - 2015 - Standard per Sistemin e Menaxhimit te Mjedisit ose ekuivalente (e vlefshme).** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).
- a) ISO 45001-2018 Standart per Menaxhimin e Shendetit dhe Sigurise ne Pune ose ekuivalente (e vlefshme).** Certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave te punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMbledhës I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Punët/ pajisjet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet, mbi kapacitetin e, të cilave do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentacit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në

<p>ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p>	<p>formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p>	<p>Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]</p>

B: DEKLARATA Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura



Deklarata	Përgjigje
<p>Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:</p>	<p>_____</p>
<p>1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;</p>	<p>Po []</p>
<p>2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;</p>	<p>Po []</p>
<p>3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;</p>	<p>Po []</p>
<p>5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:</p> <p>a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti/Enti Kontraktor;</p> <p>b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .</p>	<p>Po []</p>
<p>6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;</p>	<p>Po [] Jo []</p>
<p>7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një</p>	<p>Po [] Jo []</p>

bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).	
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me : a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	Po [] Jo []
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose kërkesat specifike të punëve shërbimeve/apo pajisjeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATA M

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike. Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë: - Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrot, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i

Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2022 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të vetme se:	
1. Operatori ekonomik garanton mbrojtjen e së drejtës për punësim dhe profesion nga çdo formë e diskriminimit parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.	Po [] Jo []
2. Operatori ekonomik ka kontratat përkatëse të punës me punonjësit e tij dhe garanton masa sigurie dhe shëndetësore për të gjithë dhe, në veçanti, për grupet në nevojë, bazuar në legjislacionin e punës	Po [] Jo []

në fuqi.	
3. Operatori ekonomik nuk ka ndonjë masë efektive ligjore të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Sociale (ISHPSHSH). Në rastet kur janë identifikuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.	Po [] Jo []

Pjesa III: Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË “Per permbushjen e specifikimeve teknike dhe grafikut e realizimit të objektit të kontratës”

Deklarata	Përgjigje
